



Pranuar / Doretuar Punijena / Prodato Received / Delivery	05-08	2022	viti god. year
Organ / Rreستا Org / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/NDHCK	4557/2022		1/1



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.565/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.565/2022 të datës 24.06.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 05.08.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si bazuar ankesa me numër A.nr.565/2022 e datës 24.06.2022 e parashtruar nga ankuesi.
- II. Obligohet Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesit ti njoh të drejtën e shfrytëzimit të gjashtë (6) ditëve të pushimit vjetor të bartura nga viti 2021 në periudhën e mbetur të vitit 2022.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi punësuar në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë më datë 24.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3693/2022 në Këshillin e Pavarur



Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për mos aprovimin e pushimit vjetor nga udhëheqësi i drejtpërdrejt.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Ndërsa Këshilli më datë 26.07.2027 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me provat lidhur me këtë çështje juridike.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 3693/2022 të datës 24.06.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 17.01.2022 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; Listën e pushimeve vjetore për vitin 2022 për ankuesin; Emailin e datës 10.06.2022 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ Kërkesën për Pushim për ditët 20.06.2022 deri 01.07.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 16.06.2022 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ Kërkesën për Pushim për ditët 23.06.2022 deri 08.07.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 22.06.2022, nga ankuesi për \_\_\_\_\_ Emailin e datës 23.06.2022 ng: \_\_\_\_\_ për ankuesin; Emailin e datës 23.06.2022 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ Emailin e datës 24.06.2022 nga ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 26.07.2022; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 01.09.2015; Kërkesën për Pushim për ditët 30.05.2022 deri 07.06.2022 nga ankuesi; Kërkesë për pushim vjetor e datës 23.06.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 22.06.2022 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ Emailin e datës 08.04.2022, 06.04.2022 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; Emailin e datës 06.04.2022, 01.04.2022 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ Kërkesën për pushim vjetor e datës 25.05.2022 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; Emailin e datës 23.05.2022, 29.04.2022 nga ankuesi për \_\_\_\_\_

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se është e bazuar ankesa e ankuesit **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore në pozitën e punës "Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale". I njëjti më datë 10.06.2022 ka parashtruar kërkesë për pushim vjetor për periudhën nga data 20.06.2022 deri më datë 01.07.2022, ndërsa më datë 16.06.2022 ka bërë përditësimin e kërkesës për pushim vjetor, duke kërkuar pushim vjetor për periudhën 23.06.2022 deri më datë 08.07.2022, ku gjashtë (6) ditë të këtij pushimi janë të bartura nga vitit 2021. Udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit me datë 23.06.2022 në përgjigje të kërkesës së ankuesit për pushim vjetor, ka njoftuar të njëjtin së pushimin vjetor të vitit 2022 mund ta shfrytëzoni prej datës 01.07.2022 dhe njëkohësisht kërkon që deri me 30 qershor të kryeni të gjitha obligimet që keni mbetur pa i plotësuar ndaj institucionit.



Më tej, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës Kolegji gjen se ankuesi po më datë 23.06.2022 ka njoftuar Mbikëqyrësin tij se ka përfunduar të gjitha obligimet, duke kërkuar që pushimi të aprovohet për faktin që ka gjashtë (6) ditë të bartura nga viti 2021 dhe se bazuar në dispozitat ligjor duhet të shfrytëzohen vetëm deri në fund të muajit qershor.

Pas mos miratimit të kërkesës për pushim vjetor të datës 16.06.2022, ankuesi parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimi se udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt në kundërshtim me rregullativën në fuqi nuk ka aprovuar pushimin vjetor. Kërkon që Këshilli ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën dhe ta detyroj Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë që ankuesit gjashtë (6) ditët e pushimit vjetor të vitit 2021 ti barten si ditë të lira në pjesën e mbetur të vitit 2022.

Në kuptim të vendosjes meritore të kësaj çështje, Kolegji sjell në vëmendje faktin se bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht sipas nenit 18 paragrafi 4 të këtij ligji, pushimet e zyrtareve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës, ndërlidhur me këtë e drejta e pushimit të nëpunësve civil është përcaktuar edhe me Rregulloren (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ju referua nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *1. Zyrtari publik për çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej njëzet (20) ditëve.* Ndërsa sipas nenit 10 po të kësaj Rregullore e drejta e pushimi vjetor mund të shfrytëzohet deri me 30 Qershor të vitit të ardhshëm, në dy (2) apo më shumë pjesë, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke u bazuar në provat e lëndës Kolegji ka konstatuar së ankuesit i është mohuar e drejta e shfrytëzimit të ditëve të pushimit vjetor të bartura nga viti 2021, dhe mbi këtë bazë konstatimi, Kolegji vlerëson se zëvendësuesi i Udhëheqësit Ekzekutiv në cilësi të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit me mos aprovimin e shfrytëzimit të ditëve të pushimit të bartura nga viti paraprak, ka vepruar në kundërshtim me nenin 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, me të cilin është theksuar se: *Të punësuarit nuk mund t'i mohohet e drejta në shfrytëzimin e pushimit vjetor.*

Po ashtu Kolegji i Këshillit në kuptim të bazushmerisë së pretendimeve ankimore ka analizuar nenin 10 Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë ku në paragrafin 2 të këtij neni përshihet se *çdo mbikëqyrës i drejtpërdrejtë harton dhe përcjell njësinë e menaxhimit e burimeve njerëzore, brenda muajit Janar, planin orientues të shfrytëzimit të pushimeve vjetore prej zyrtarëve publikë në varësi, në përputhje me kërkesat e këtyre zyrtarëve dhe nevojat e institucionit,* kështu që në mungesë të një plani vjetor mbi shfrytëzimin e pushimit vjetor, ankuesi në respektim të plotë të nenit 10 paragrafi 3 të kësaj Rregullore me datë 16.06.2022 ka parashtruar kërkesë për pushim vjetor, ndërsa Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt pas 7 ditësh pra në ditën ku ankuesi duhej të fillonte pushimin reagon ndaj kërkesës së ankuesit duke mos aprovuar kërkesën e tij për pushim sipas datave të përcaktuara nga ankuesi, duke vepruar kështu në kundërshtim edhe me nenin 37 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, i cili përcakton se: *Me*





*rastin e lejimit të pushimit vjetor, punonjësit i lëshohet vendim për orarin dhe kohëzgjatjen e pushimit vjetor më së paku pesë (5) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor”.*

Përkitazi me çështjen e kompensimit të ditëve të pashfrytëzuara të pushimit vjetor, Kolegji ju referua nenit 38 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës ku përcaktohet se: 2. *I punësuari që nuk e ka shfrytëzuar pushimin vjetor apo një pjesë të pushimit me fajin e punëdhënësit, ka të drejtë për ta shfrytëzuar atë pushim gjatë periudhës vijuese e cila i konvenon punëmarrësit, apo kompensim me të holla.* 3. *Lartësia e kompensimit nga paragrafi 2. i këtij neni, caktohet varësisht nga kohëzgjatja e pushimit vjetor të pashfrytëzuar sipas të ardhurave të cilat i punësuari i realizon për muajin kur kompensohet”,* andaj, mbi këtë bazë ligjore dhe meqenëse ankuesi pa fajin e tij nuk ka shfrytëzuar gjashtë (6) ditë të bartura të pushimit vjetor të vitit 2021, si dhe duke pas parasysh vet petitumin e ankesës, Kolegji konstaton se Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore është i obliguar që ankuesit ti njoh të drejtën e shfrytëzimit të gjashtë (6) ditëve të pushimit vjetor të bartura nga viti 2021 në periudhën e mbetur të vitit 2022.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Siç u tha me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.565/2022

**Avdyl BEKTESHI**

*Avdyl Bekteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Ardita Haxhnikaj*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

